



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
LICENCIMIN E SUBJEKTEVE QË USHTROJNË VEPRIMTARINË SI AGJENT I
TOKENIT DIGJITAL

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 211, datë 25.11.2021

KREU I

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave të detajuara të licencimit, llojit të dokumenteve provuese, mënyrën e shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumenteve dhe detyrimet për raportim të subjekteve që ushtrojnë osë kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë si agjent i tokenit digjital.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 9, pika 2 dhe 3, nenit 15, pika 6 dhe nenit 21, pika 5, të Ligjit 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”.

Neni 3
Fusha e veprimtarisë

Dispozitat e kësaj rregulloreje i shtrijnë efektet e tyre mbi të gjithë personat juridikë që ushtrojnë ose kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si agjent i tokenit digjital në Republikën e Shqipërisë, ose nga Republika e Shqipërisë, për klientë që ndodhen jashtë saj.

Neni 4
Përkufizime

1. “**Autoriteti**” është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

2. **“Licencë e kufizuar e agjentit TD”** është licenca e përkohshme e cila i lejon subjektit kërkues për licencë agjenti TD të ushtrojë një numër të kufizuar të veprimtarive, sipas përcaktimeve të nenit 38 të kësaj rregulloreje.
3. **“Ligji”** është Ligji 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjine e regjistrave të shpërndarë.
4. **“Paketa e Dokumenteve”** është i gjithë seti i dokumenteve që dorëzohet pranë AMF nga ana e subjekteve kërkuese me qëllim marrjen e licencës sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje dhe legjislacionit të fuqi.
5. **“Personel kyç”** është çdo person fizik/individ i cili mban një ose më shumë nga funksionet e mëposhtme në shoqërinë e subjektit kërkues/agjentit TD:
 - Drejtori i Departamentit të Administrimit të Rrezikut;
 - Drejtori i Departamentit të Auditimit të Brendshëm;
 - Drejtori i Departamentit të Financës;
 - Drejtori i Departamentit të Përputhshmërisë;
 - Zyrtari përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
6. **“Programi i monitorimit të përputhshmërisë”** është dokumenti i cili parashtrohet në mënyrë të detajuar të gjitha kontrollet periodike që do të ushtrojë agjenti TD, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.
7. **“Titullari i licencës së kufizuar të agjentit TD”** është çdo subjekt kërkues i cili ka marrë një licencë të kufizuar të agjentit TD në përputhje me nenin 40 të kësaj rregulloreje.
8. **“ZPPPF”** është zyrtari përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Të gjitha përkufizimet e listuara në nenin 3, të Ligjit 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore.

Neni 5

Shqyrtimi i kërkesës për licencim

1. Pas marrjes në dorëzim të kërkesës për licencim dhe paketës së dokumenteve, Autoriteti kryen shqyrtimin dhe vlerësimin e tyre në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe legjislacionit në fuqi.
2. Autoriteti e mbështet vendimarrjen e tij mbi këto parime të përgjithshme:
 - a. Mbrojtjen e interesave të investitorëve dhe interesit publik;
 - b. Nxitjen e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare;
 - c. Sigurimin e respektimit të ligjit.
3. Gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës për licencim, Autoriteti vlerëson dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti kërkues, duke marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:
 - a. Përmbushjen e kriterëve për përshtatshmëri dhe aftësi të aksionarëve, administratorit, anëtarëve të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës, si dhe personelit kyç sipas kërkesave të ligjit dhe të kësaj rregulloreje;
 - b. Përputhshmërinë e subjektit kërkues me kërkesat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje;

- c. Kapacitetin dhe aftësinë e subjektit kërkues për të ruajtur dhe plotësuar në të ardhmen kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta të ligjit dhe kësaj rregulloreje.

Neni 6

Dhënia e licencës

1. Në rastet kur Autoriteti, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës për licencim sipas përcaktimeve të nenit 5 të kësaj rregulloreje, gjykon se subjekti kërkues i përmbush të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore për të ushtruar veprimtarinë si agent TD, Autoriteti lëshon licencën e agentit TD në emër të subjektit kërkues, sipas afateve të përcaktuara në nenin 11 të ligjit.
2. Në vendimin për licencim të agentit TD, Autoriteti përfshin vendimin për miratimin e:
 - a. Zotëruesit të pjesëmarrjes influencuese;
 - b. Emërimit të administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç.
3. Autoriteti publikon vendimin për dhënien e licencës në faqen e tij zyrtare dhe e regjistron atë në regjistrin e agentëve TD, sipas përcaktimeve të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”.

Neni 7

Refuzimi i kërkesës për licencim

Në përputhje me nenin 6 të ligjit, Autoriteti refuzon kërkesën për licencim në rastet kur:

- a. Subjekti kërkues nuk ka kryer pagesën e tarifës së aplikimit për licencë;
- b. Autoriteti gjykon mbi baza të arsyeshme se subjekti kërkues ka dorëzuar dokumente dhe/ose informacion të rremë, të pasaktë ose jo të plotë;
- c. Autoriteti gjykon mbi baza të arsyeshme se dokumentet e dorëzuara nga subjekti kërkues janë të pamjaftueshme dhe/ose subjekti kërkues nuk përmbush kushtet e kriteret për licencim;
- ç. Autoritet gjykon mbi baza të arsyeshme se subjekti kërkues nuk do të jetë i aftë të plotësojë në të ardhmen kushtet e kriteret për licencim.

Neni 8

Transferimi i licencës

1. Titullari i licencës nuk mund të delegojë ose ta transferojë licencën te një palë e tretë, pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit.
2. Titullari i licencës duhet të njoftojë paraprakisht autoritetin përgjegjës për çdo qëllim të tij lidhur me delegimin ose transferimin e licencës te një palë e tretë.
3. Autoriteti miraton ose refuzon delegimin apo transferimin e licencës brenda 15 ditëve pune nga data e njoftimit. Në çdo rast miratimi i delegimit apo transferimit të licencës bëhet vetëm nëse personi juridik që kërkohet t’i delegohet apo transferohet licenca plotëson kushtet e përcaktuara nga ky ligj.

4. Çdo delegim ose transferim i licencës në kundërshtim me këtë nen, konsiderohet si akt absolutisht i pavlefshëm.
5. Autoriteti mund të pezullojë ose të heqë licencën e titullarit në rast të shkeljes së këtij neni.

Neni 9

Dorëzimi vullnetar i licencës

1. Agjenti TD mund të dorëzojë vullnetarisht licencën e tij duke dorëzuar pranë Autoritetit kërkesën për dorëzimin e licencës, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
2. Kërkesa për dorëzimin e licencës duhet të shoqërohet me dokumente ose deklarata noteriale, sipas rastit, që vërtetojnë se agjenti TD:
 - a. Ka përfunduar të gjitha shërbimet ndaj klientëve aktualë;
 - b. Nuk ka detyrime kundrejt palëve të treta;
 - c. Nuk është palë ndërgjyqëse në procese gjyqësore në Shqipëri;
 - ç. Konfirmon ruajtjen në vijimësi të fondeve të veta për të paktën 6 muaj;
 - d. Ka trajtuar ankesat e mundshme ndaj tij në përputhje me politikat dhe rregullat e brendshme të tij dhe se nuk ka asnjë ankesë të patrajtuar.
3. Autoriteti shqyrton kërkesën për dorëzimin e licencës dhe dokumentet shoqëruese dhe merr vendim brenda 30 ditëve pune në lidhje me miratimin ose jo të kërkesës.
4. Vendimi sipas pikës 3 të këtij neni, publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit ose refuzimit të kërkesës.

Kreu II

PAKETA E DOKUMENTEVE

Neni 10

Dispozita të përgjithshme

1. Çdo subjekt kërkues i cili kërkon të ushtrojë veprimtarinë si agjent TD, duhet të dorëzojë kërkesën për licencim sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje. Kërkesës për licencim i bashkëlidhet paketa e dokumenteve, sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar në ligj dhe në këtë rregullore.
2. Kërkesa për licencim plotësohet dhe nënshkruhet nga përfaqësuesi/t ligjor/ë të subjektit kërkues si dhe nga çdo individ sipas kërkesave të seksioneve përkatëse.
3. Paketa e dokumenteve përbëhet nga:
 - a. Dokumente mbi organizimin dhe veprimtarinë e shoqërisë;
 - b. Dokumente mbi reputacionin e subjektit kërkues dhe burimin e kapitalit;
 - c. Dokumente në lidhje me politikat, rregulloret e brendshme, procedurat dhe sistemet e shoqërisë;
 - ç. Dokumente mbi plotësimin e kritereve të kapitalit fillestar të shoqërisë;

- d. Dokumente mbi plotësimin e kriterëve të aftësisë dhe përshtatshmërisë dhe njohurive të duhura teknike;
- dh. Dokumente që vërtetojnë kryerjen e programeve të trajnimit të detyrueshëm të përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
4. Dokumentet, pjesë përbërëse të paketës së dokumenteve, duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të lëshuara jo më parë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes në Autoritet dhe shoqëruar, sipas rastit, me vulë apostile, sipas kërkesave të Ligjit nr. 9060, datë 8.5.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja”. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti ose të dokumenteve të pasakta përbëjnë shkak për refuzimin e kërkesës për licencim.

Neni 11

Dokumentet mbi organizimin dhe veprimtarinë e shoqërisë

Dokumentet mbi krijimin dhe organizimin e subjektit përmbajnë si më poshtë:

1. Ekstraktin e regjistrimit në QKB të subjektit kërkues si shoqëri aksionare;
2. Statutin, ku objekti i veprimtarisë dhe kapitali minimal fillestar, të përputhet me veprimtarinë për të cilat subjekti kërkon të licencohet si dhe të përshkruhet roli i anëtarëve të pavarur të këshillit të administrimit, shoqëruar me një përshkrim të detyrave dhe përgjegjësisë të tyre;
3. Lista e shërbimeve dhe aktiviteteve të që synohen të kryhen;
4. Strukturën organizative/organigramën e shoqërisë, me përshkrimin mbi funksionet dhe përgjegjësitë e personelit kyç;
5. Planin e biznesit së paku për tre vitet e para të aktivitetit, duke përfshirë këtu përshkrimin e veprimtarisë së subjektit, perspektivat e zhvillimit të veprimtarisë, pritshmëritë e subjektit mbi veprimtarinë që do të kryejë, mënyrën e përmbushjes së kërkesave për mjaftueshmëri kapitali. Plani i biznesit duhet të përfshijë edhe elementët e mëposhtëm:
 - a. Planin e marketingut të shoqërisë, përfshirë klientët e synuar;
 - b. Planin financiar, duke përfshirë një përshkrim se si do të mbulohet kostoja e fillimit të veprimtarisë dhe se si do të ruhen dhe zbatohen kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit;
 - c. Programin për trajnimin e vazhdueshëm të të gjithë personelit për të përmbushur standardet për aftësitë profesionale, siç parashikohet në ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij;
6. Kontrata e punës me administratorin;
7. Deklaratën e përgjegjësisë, ku të përshkruhen përgjegjësitë e funksionarëve të cilësuar si personel kyç, si dhe përshkrimin e funksioneve dhe përgjegjësisë kryesore, në rastet kur një funksionar do të ushtrojë më shumë se një funksion të përcaktuar për personelin kyç;

8. Vërtetimin bankar që konfirmon pagesën në para, për llogari të shoqërisë, të kapitalit minimal fillestar në përputhje me nenin 29 të ligjit, i cili duhet të mbahet i bllokuar në favor të Autoritetit, në një nga bankat në Republikën e Shqipërisë. Kjo shumë zhblokohet nëpërmjet njoftimit të Autoritetit, në përfundim të procedurës së licencimit.
9. Nëse shoqëria ka ushtruar një aktivitet tjetër përpara kërkesës për të ushtruar veprimtarinë si agjent TD, përveç dokumenteve të mësipërme, duhet të depozitojë gjithashtu:
 - a. Pasqyrat financiare të audituara për 3 vitet e fundit dhe në rastin e një shoqërie më të re pasqyrat që nga krijimi;
 - b. Vërtetim nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;
 - c. Deklaratë se shoqëria nuk është nën hetim dhe/ose proces gjyqësor për kryerjen e ndonjë veprë penale.
 - ç. Dokument që vërteton se shoqëria nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera

Neni 12

Dokumentet mbi reputacionin dhe burimin e kapitalit

Dokumentet mbi aksionarët dhe burimin e kapitalit përmbajnë si më poshtë:

1. Strukturën aksionare të kapitalit të shoqërisë;
2. Për aksionarët me pjesëmarrje influencuese në shoqërinë kërkuese, një përmbledhje e veprimtarisë/aktivitetit të tyre;
3. Të dhëna për shoqëri të tjera, ku aksionari me pjesëmarrje influencuese në shoqërinë e agjentit TD, është aksionar/ortak kryesor ose ushtron kontroll;
4. Strukturën dhe listën e aksionarëve përfitues fundorë të shoqërisë kërkuese;
5. Të dhëna për integritetin dhe burimin e kapitalit.
 - I. Kur aksionari është person juridik, shoqëria kërkuese duhet të depozitojë:
 - a. Ekstraktin e regjistrimit në QKB;
 - b. Pasqyrat financiare të audituara për 3 vitet e fundit, dhe në rastin e një shoqërie më të re pasqyrat që nga krijimi;
 - c. Dokument të lëshuar nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;
 - ç. Vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredive në sistemin bankar;
 - d. Deklaratë se shoqëria nuk është nën hetim dhe/ose proces gjyqësor për kryerjen e ndonjë veprë penale;
 - dh. Dokument se shoqëria nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.
 - e. Vërtetim nga gjykata që shoqëria nuk është në proces gjyqësor penal apo civil.
 - II. Kur aksionari është individ, subjekti kërkuës duhet të depozitojë:
 - a. Dokument identifikimi (ID/ pasaportë);

- b. Curriculum vitae;
 - c. Diploma, kualifikime, trajnime;
 - ç. Dëshmi të burimeve të krijimit të kapitalit si blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, apo dëshmi të tjera për burimin e krijimit të kapitalit;
 - d. Dokument i lëshuar nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;
 - e. Vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredive në sistemin bankar;
 - ë. Dokumente të lëshuara nga organet kompetente si më poshtë:
 - i. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
 - ii. Vërtetim nga prokuroria për hetim penal në proces;
 - iii. Vërtetim nga gjykata për çështje gjyqësore në proces;
 - iv. Dokument lidhur me procese ekzekutimi të detyrueshëm apo për detyrime pasurore të pashlyera;
 - v. Deklaratë personale për lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë sipas shtojcës 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
6. Dokumentet e parashikuara në pikën 5 të këtij neni, plotësohen edhe nga aksionarët e aksionarit person juridik me pjesëmarrje influencuese, që zotërojnë mbi 25% të aksioneve me të drejtë vote. Kjo kërkesë duhet të plotësohet nga agjenti TD gjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së licencës.

Neni 13

Politikat, rregulloret, procedurat dhe sistemet e brendshme të shoqërisë

1. Dokumentet mbi rregulloret, politikat, procedurat dhe sistemet e brendshme të shoqërisë së subjektit kërkues duhet të përmbajnë:
 - a. Rregullore të brendshme mbi parandalimin dhe trajtimin e konfliktit të interesave;
 - b. Rregullore të brendshme mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
 - c. Rregullore të brendshme në lidhje me delegimin e funksioneve/detyrave;
 - ç. Rregullore dhe sisteme të brendshme në lidhje me sigurinë kibernetike;
 - d. Rregullore të brendshme mbi përshtatshmërinë e klientit;
 - e. Rregullore dhe sisteme të brendshme për menaxhimin e rrezikut;
 - ë. Rregullore të brendshme për parandalimin e abuzimit të tregut;
 - f. Rregullore dhe sisteme të brendshme për monitorimin e përputhshmërisë.
2. Dokumentet e listuara në pikën 1 të këtij neni duhet të hartohen në përputhje me përcaktimet e neneve 14 - 21 të kësaj rregulloreje.

Neni 14

Parandalimi dhe trajtimi i konfliktit të interesit

1. Në përputhje me nenin 30 të ligjit, subjekti kërkues ose agjenti TD duhet të dorëzojë pranë Autoritetit një deklaratë noteriale përmes së cilës duhet të konfirmojë se:
 - a. Agjenti TD është i pavarur nga subjekti kërkues/titullari i licencës dhe nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë prej tyre.
 - b. Veprimtaria e agjentit TD ka qënë dhe do të vijojë të jetë në përputhje me detyrimet e përcaktuara në rregulloret e brendshme të tij për parandalimin e konfliktit të interesit, duke evidentuar në mënyrë të rregullt të gjitha rastet e mospërputhshmërisë.
2. Agjenti TD do të konsiderohet të jetë në kushtet e konfliktit të interesit në raster kur:
 - a. Një ose më shumë nga funksionarët e agjentit TD ushtron një nga funksionet e përcaktuara në Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, në kundërshtim me dispozitat e atij ligji.
 - b. Një ose më shumë nga funksionarët e agjentit TD gjendet në kushtet e konfliktit të interesit të përcaktuara në Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
3. Agjenti TD harton rregullore të brendshme efektive për parandalimin dhe trajtimin e konfliktit të interesave, e cila është proporcionale me madhësinë, strukturën, kompleksitetin dhe mënyrën e organizimit të shoqërisë së agjentit TD dhe i përmbahet përcaktimeve të saj në vijimësi. Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesave përditësohet në mënyrë periodike të paktën një herë në vit.
4. Agjenti TD regjistron rast pas rasti të gjitha konfliktet e interesave të funksionarëve të tij. Për regjistrimin e konflikteve rast pas rasti të interesave të funksionarëve të agjentit TD, krijohet regjistri me të njëjtin emër.
5. Regjistri i konfliktit të interesave të funksionarëve të agjentit TD përmban minimalisht të dhënat e mëposhtme:
 - a. Identitetin e funksionarit;
 - b. Interesat private të tij;
 - c. Shkakun e konfliktit të interesit;
 - ç. Thelbin e këtij konflikti;
 - d. Palët e interesuara që janë përfshirë në të;
 - e. Burimin e të dhënave;
 - ë. Mënyrën e marrjes dhe të verifikimit të tyre.

Neni 15

Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

Agjenti TD është subjekt i rregullores së AMF nr. 58 datë 30.06.2015 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e ndryshuar dhe zbaton me përpikmëri të gjitha detyrat e përcaktuara në të për ofruesit e shërbimeve të mjeteve virtuale si dhe zbaton çdo detyrim tjetër të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Neni 16

Delegimi i funksioneve dhe/ose detyrave

1. Në rastet kur agjenti TD, delegon një pjesë të funksioneve ose detyrave të tij tek një palë e tretë, Agjenti TD duhet të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur një nivel të përshtatshëm të ofrimit të shërbimit ndaj klientëve të tij.
2. Agjenti TD është përgjegjës për cilësinë e shërbimit të ofruar dhe për të gjitha dëmet ose pasojat që mund të shkaktohen si rrjedhojë e delegimit të detyrave të tij tek një palë e tretë.
3. Agjenti TD ose subjekti kërkues, si pjesë e paketës së dokumenteve, duhet të hartojë dhe përditësojë në vijimësi rregullore të brendshme dhe procedura në lidhje me delegimin e funksioneve dhe/ose detyrave tek palët e treta, të cilat duhet të përfshijnë qasjen e agjentit TD ndaj delegimit, planet e emergjencës, strategjitë e daljes, rastet kur delegimi kryhet brenda të njëjtës strukturë korporative, si dhe rregulla të përgjithshme që mbulojnë të gjitha aspektet e delegimit të funksioneve dhe/ose detyrave. Rregullat e brendshme duhet të përmbajnë gjithashtu informacion në lidhje me ndërmarrjen e masave të arsyeshme për të shmangur riskun operacional në rastet e delegimit të funksioneve të rëndësishme.
4. Çdo marrëveshje për delegimin e funksioneve dhe/ose detyrave duhet të jetë e noterizuar dhe duhet të përmbajë qartazi të drejtat dhe detyrimet e secilës palë.

Neni 17

Politikat dhe sistemet në kuadër të sigurisë kibernetike

1. Agjenti TD vendos dhe mirëmban sisteme të qëndrueshme në kuadër të sigurisë kibernetike, të cilat mundësojnë ruajtjen dhe transferimin e sigurt të të dhënave, duke ulur mundësinë e humbjes së të dhënave ose sulmeve potenciale kibernetike.
2. Agjentit TD siguron gjithashtu konfidencialitetin e të dhënave personale dhe të palëve të treta duke vendosur rregulla dhe sisteme për të parandaluar qasjen e paautorizuar dhe rrjedhjen e informacionit.

Neni 18

Politikat dhe rregulloret për menaxhimin e rrezikut

Agjenti TD ose subjekti kërkues, sipas rastit, harton dhe dorëzon si pjesë e paketës së dokumenteve, dokumente që përmbajnë informacion mbi natyrën e rreziqeve që lidhen me llojin e shërbimeve që do të ofrojë, mënyrën e identifikimit të tyre, matjes, menaxhimit dhe zbutjes, duke parashikuar treguesit që do të përdoren për nivelin e rrezikut që do të marrë përsipër, përfshirë emrat e personave përgjegjës për këtë funksion.

Neni 19

Përshtatshmëria e klientëve

Agjenti TD ose subjekti kërkues, sipas rastit, harton politika të brendshme në lidhje me pranimin dhe përshtatshmërinë e klientëve, të cilat duhet të përmbajnë minimalisht:

- a. Rregulla dhe procedura për klasifikimin e klientëve;

- b. Një përshkrim të proceseve të brendshme për pranimin e klientëve, duke përcaktuar edhe departamentet përkatëse që do të përfshihen në këtë proces;
- c. Rregulla dhe procedura refuzimin e klientëve;
- ç. Rregulla dhe procedura për monitorimin e vazhdueshëm të veprimtarisë dhe dokumentacionit të klientëve.

Neni 20

Politikat dhe rregulloret për parandalimin e mashtrimit dhe abuzimit me tregut

Agjenti TD ose subjekti kërkues, sipas rastit, harton politika të brendshme në lidhje me parandalimin e mashtrimit dhe abuzimit me tregut, të cilat duhet të përmbajnë minimalisht:

- a. Rregulla dhe procedura për trajtimin e informacionit të brendshëm;
- b. Rregulla dhe procedura për publikimin e informacionit;
- c. Rregulla dhe procedura për tregtimin e brendshëm;
- ç. Rregulla dhe procedura për kumbuesit e tregut;
- d. Rregulla në lidhje me strukturën e kontrollit të përputhshmërisë.

Neni 21

Rregulloret dhe sistemet e brendshme për monitorimin e përputhshmërisë

1. Në kuadër të monitorimit të përputhshmërisë ligjore të agjentit TD dhe titullarëve të licencës për të cilët vepron në emër dhe për llogari, agjenti TD emëron një prej personelit kyç si zyrtar të përputhshmërisë. Funkzioni i zyrtarit të përputhshmërisë duhet të jetë i pavarur nga çdo funksion tjetër brenda shoqërisë, përveç atij ZPPPP. Zyrtari i përputhshmërisë raporton periodikisht mbi veprimtarinë e tij pranë bordit drejtues, këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit, të paktën çdo 3 muaj.
2. Agjenti TD gjithashtu vendos dhe mirëmban një program të monitorimit të përputhshmërisë, i cili përcakton kontrollet periodike që do të kryhen në vazhdimësi për të siguruar përputhshmërinë e agjentit TD dhe titullarëve të licencës për të cilët vepron në emër dhe për llogari, me legjislacionin në fuqi. Programi i monitorimit të përputhshmërisë dhe të gjitha të dhënat e ndodhura në të vendosen menjëherë në dispozicion të Autoritetit pas kërkesës paraprake me shkrim nga ana e Autoritetit.
3. Agjenti TD vlerëson periodikisht përputhshmërinë e titullarëve të licencës për të cilët vepron në emër dhe për llogari, në përputhje me programin e monitorimit të përputhshmërisë, të paktën një herë në tre muaj. Kopjet origjinale të rezultateve të vlerësimit të përputhshmërisë mbahen në selinë qendrore të agjentit TD dhe i vihen menjëherë në dispozicion Autoritetit pas një kërkesë paraprake me shkrim nga ky i fundit.
4. Me qëllim vërtetimin e përputhshmërinë me dispozitat e ligjore në fuqi, agjenti TD do të krijojë dhe mirëmbajë mbajë një regjistër fizik dhe digjital ku do të evidentohen të gjitha dokumentet/informacionet e grumbulluara si dhe sqarimet e dhëna Autoritetit në emër dhe për llogari të titullarëve të licencës nga ana e agjentit TD. Regjistri duhet të përmbajë minimalisht kohën, datën përkatëse, të dhënat mbi llojin e dokumentit/informacionit dhe detajet e titullarëve të licencës.

5. Agjenti TD përcakton dhe mban në vazhdimësi rregulla dhe procedura të brendshme përshtatshme për raportimin e shkeljeve nga ana e punonjësve të tij.
6. Agjenti TD vlerëson përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve dhe rregulloreve të brendshme të tij në mënyrë periodike çdo 6 (gjashtë) muaj dhe merr masa për të adresuar çdo mangësi të konstatuar.
7. Agjenti TD ruan të gjitha të dhënat dhe informacionin që vërtetojnë pëprthshmërinë ligjore të tij dhe të titullarëve të licencës për të cilët vepron në emër dhe për llogari, për të paktën 5 (pesë) vitet e fundit.

Neni 22

Kapitali fillestar minimal

1. Në përputhje me nenin 29 të ligjit, çdo agjent TD duhet të vërtetojë se ka një kapital fillestar minimal prej 18,000,000 (tetëmbëdhjetë milionë) lekësh duke vënë në dispozicion kopjen e dokumentit përkatës/garancinë e lëshuar në një nga bankat e nivelit të dytë që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Dokumentet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, vihen në dispozicion si një dokument bankar që vërteton pagimin e kapitalit minimal në para prej 18,000,000 (tetëmbëdhjetë milionë) lekësh, në një nga bankat e nivelit të dytë që veprojnë në territorin e R.Sh.
3. Dokumentet përkatëse duhet t'i bashkëlidhen kërkesës për aplikimin e cila duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinale ose kopje të noterizuara, jo më të hershme se tre muaj nga data e aplikimit.

Neni 23

Fondet e veta për të mbuluar përgjegjësitë profesionale të agjentit TD

Agjenti TD duhet të sigurojë se ka mjaftueshëm fonde të veta për të mbuluar përgjegjësitë profesionale në përputhje me përcaktimet e rregullores përkatëse, të nxjerrë nga Autoriteti.

Kreu III

KËRKESAT PËR AFTËSI DHE PËRSHTATSHMËRI

Neni 24

Personat që i nënshtrohen kërkesës për aftësi dhe përshtatshmëri

1. Administratori/ët, anëtari i këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit dhe personeli kyç i agjentit TD, duhet të përmbushin kërkesat për aftësi dhe përshtatshmëri si dhe të zotërojnë njohuritë e duhura teknike dhe ligjore sipas përcaktimeve të neneve 9 dhe 29 të ligjit.
2. Personat e listuar në pikën 1 të këtij neni, depozitojnë informacionin dhe dokumentet e përcaktuara në nenin 25 të kësaj rregulloreje sipas formularëve të shtojcës 1 bashkëlidhur.

3. Autoriteti si pjesë e procesit të licencimit, vlerëson përmbushjen e kërkesave ligjore për aftësi dhe përshtatshmëri të zotëruesit/ve të pjesëmarrjes influencuese dhe personelit kyç të shoqërisë.

Neni 25

Dokumentet për administratorin, anëtarin e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelin kyç

1. Agjenti TD ose subjekti kërkues, sipas rastit, dorëzon pranë Autoritetit dokumentet mbi administratorin, anëtarin e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe funksionarin në pozicionet e përcaktuar si personel kyç, si më poshtë:
 - a. Dokument identifikimi (ID/ pasaportë);
 - b. Curriculum Vitae, ku të detajohet përvoja profesionale;
 - c. Diploma, kualifikime, trajnime dhe dokumenta të tjera me rëndësi që vërtetojnë arritjet akademike dhe profesionale;
 - ç. Dokument i lëshuar nga administrata tatimore për gjendjen e detyrimeve tatimore;
 - d. Vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredive në sistemin bankar.
2. Dokumente të lëshuara nga organet kompetente, si më poshtë:
 - a. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
 - b. Vërtetim nga prokuroria për hetim penal në proces;
 - c. Vërtetim nga gjykata për çështje gjyqësore në proces;
 - ç. Dokument lidhur me procese ekzekutimi të detyrueshëm apo për detyrime pasurore të pashlyera.
3. Deklaratë noteriale se:
 - a. Nuk është përfshirë, ka bashkëpunuar ose është i lidhur me humbje financiare, të shkaktuara nga veprimet e pandershme, të papërgjegjshme apo neglizhente, në lidhje me kryerjen e shërbimeve financiare dhe administrimin e shoqërive të tjera; ose
 - b. Nuk ka zotëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, të paktën 50% të të drejtave të votës apo të kapitalit të një shoqërie tregtare, ose ka qenë administrator i një shoqërie tregtare, e cila është bërë objekt i procedurave të falimentimit, në zbatim të ligjit për falimentimin;
 - c. Nuk është përfshirë në ndonjë praktikë tregtare, përfshirë edhe evazionin fiskal dhe pastrimin e parave, që Autoriteti e konsideron të papërshtatshme, qoftë e ligjshme ose jo, e cila hedh dyshime për mënyrën e kryerjes së shërbimeve financiare apo të veprimtarive të tjera tregtare nga ky person.
4. Deklaratë noteriale për lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë sipas shtojcës 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Neni 26

Njohuritë e duhura tekniko ligjore

1. Në përputhje me nenin 29, pika 1(a) të ligjit, administratori/ët, anëtari i këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit dhe personeli kyç i agjentit TD ose subjektit kërkues, duhet të vërtetojnë plotësimin e kriterit për zotërimin e aftësive dhe njohurive të duhura tekniko-ligjore.
2. Për qëllime të pikës 1 të këtij neni, agjenti TD duhet të vërtetojë, nëpërmjet dokumenteve provuese, se personat e sipërlistuar brenda strukturës së tij, kanë të paktën 3 vite përvojë profesionale duke ushtruar me kohë të plotë veprimtarinë e tyre në secilën prej fushave të mëposhtme:
 - a. Veprimtari në fushën e drejtësisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në profesionet avokat, noter, këshilltar ligjor, etj.
 - b. Veprimtari në fushën e financave, duke përfshirë por pa u kufizuar në profesionet si Financier, kontabilist, ekonomist, ndërmjetësues financiar, këshilltar Ekonomik/Financiar etj.
 - c. Veprimtari në fushën e teknologjisë së informacionit si – zhvillues rrjeti(web), inxhinier DevOps, arkitekt i sistemit të informacionit/cloud, administrator rrjeti, zhvillues aplikacionesh, administrator baze të dhënash, zhvillues *Full Stack*, konsulent i sigurisë kibernetike, drejtues i strukturave të teknologjisë së informacionit.
 - ç. Përvojë akademike në fushën e drejtësisë, financave ose teknologjisë së informacionit.
3. Kryetari i këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit përmbush një nga kriteret e listuara në pikën 2, për të paktën 5 vite.
4. Personat e listuar në pikën 1 të këtij neni, duhet të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master Shkencor”, ose të barazvlefshme, në fushën e drejtësisë, ekonomisë, financave dhe teknologjisë së informacionit.
5. Dokumentet provuese për përmbushjen e kritereve të listuara në pikën 2 dhe 3 të këtij neni janë:
 - a. Kontrata punësimi ose kontrata për ofrimin e shërbimeve;
 - b. Licencat përkatëse, nëse janë të aplikueshme;
 - c. Libreza e punës, nëse është e aplikueshme;
 - ç. Vërtetim për pagesën e kontributeve shoqërore;
 - d. Diploma universitare brenda ose jashtë Shqipërisë.
6. Kriteret e përcaktuara në pikat 2 dhe 4 të këtij neni, përmbushen bashkërisht nga të gjithë personat e listuar në pikën 1.

Neni 27

Përgjegjësia e Agjentit TD

Krahas parashikimeve të nenit 32 të ligjit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë në emër dhe për llogari të titullarëve të tjerë të licencës, agjenti TD mban përgjegjësi për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të vendosura në dispozicion nga klientët e tij, përveç rasteve kur agjenti TD mund të provojë se pasaktësia ose falsifikimi i tyre ishte e pamundur të konstatohej gjatë kryerjes së një vlerësimi profesional të arsyeshëm të të dhënave të vendosura në dispozicion.

KREU IV MIRATIMI I NDRYSHIMEVE

Neni 28 Ndryshimet që kërkojnë miratim

Autoriteti miraton paraprakisht çdo veprim të agjentit TD në lidhje me:

- a. Ofrimin në mënyrë direktë ose indirekte të shërbimeve të tij jashtë Shqipërisë, duke themeluar një degë të shoqërisë në vendin përkatës ose duke i ofruar shërbimet e tij nga Shqipëria;
- b. Ndryshimin e zotëruesve të pjesëmarrjes influencuese;
- c. Emërimin, zëvendësimin e administratorit, anëtarëve të këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit dhe personelit kyç, duke përfshirë ZPPPPFT.

Neni 29

Kërkesa dhe dokumentet për ofrimin e shërbimeve jashtë Republikës së Shqipërisë

1. Agjenti TD mund të ofrojë shërbimet e tij jashtë Republikës së Shqipërisë nëpërmjet vendosjes së një dege ose duke i ofruar ato nga Republika e Shqipërisë, me kusht që shërbimet dhe veprimtaritë që propozon të ofrojë jashtë Republikës së Shqipërisë të përfshihen në një licencë të dhënë nga Autoriteti.
2. Agjenti TD, që dëshiron të regjistrojë një degë jashtë Republikës së Shqipërisë, njofton paraprakisht Autoritetin dhe i jep informacionet e mëposhtme:
 - a. Programin e veprimtarive, ku përkruhen, ndër të tjera, shërbimet që propozon të ofrojë në vendin e huaj;
 - b. Strukturën organizative të degës,;
 - c. Adresën në vendin e huaj nga e cila mund të merren dokumente;
 - d. Emrat e personave, të cilët janë përgjegjës për administrimin e degës; dhe
 - e. Konfirmimin nga autoriteti i huaj rregullator se agjenti TD mund të kryejë veprimtaritë e propozuara në vendin e huaj, në rast se është e aplikueshme.

Neni 30

Kërkesa dhe dokumentet për ndryshime të zotëruesve të pjesëmarrjes influencuese

1. Personi fizik ose juridik që kërkon të zotërojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, pjesëmarrje influencuese ose kërkon të rrisë, shesë ose zvogëlojë zotërimin e pjesëmarrjes influencuese në shoqërinë e agjentit TD, njofton paraprakisht me shkrim Autoritetin për qëllimin e tij.
2. Personat që kërkojnë të bëhen zotërues të pjesëmarrjes influencuese duhet të depozitojnë kërkesë sipas shtojcës 3 dhe dokumentacionin përkatës të përcaktuar në nenin 12 të kësaj rregulloreje.
3. Autoriteti, në rastet e ndryshimit të zotëruesve të pjesëmarrjes influencuese, vlerëson përshtatshmërinë e blerësit të propozuar duke marrë në konsideratë edhe kriteret sa më poshtë:

- a. Blerësi i propozuar të jetë i aftë dhe i përshtatshëm për këtë qëllim në përputhje me kërkesat e ligjit dhe kësaj rregulloreje.

Neni 31

Kërkesa dhe dokumentet për ndryshimin e administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit/ këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç

1. Agjenti TD duhet të njoftojë paraprakisht Autoritetin për çdo ndryshim të administratorit, anëtarëve të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç.
2. Për çdo person që do të emërohet si administrator, anëtar i këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës, shoqëria duhet të depozitojë kërkesë sipas shtojcës 3 të kësaj rregulloreje, si dhe dokumentacionin e përcaktuar në nenin 11 dhe 12, të përditësuar.
3. Për çdo person që emërohet në funksione brenda shoqërisë, të përcaktuara për personelin kyç, shoqëria duhet të depozitojë kërkesë sipas shtojcës përkatëse, si dhe dokumentacionin e përcaktuar në nenin 25 dhe 26, të kësaj rregulloreje.
4. Njoftimi dhe dokumentacioni përkatës, depozitohen në Autoritet 3 muaj para bërjes efektive të ndryshimeve.

Neni 32

Riemërimi i administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës të dhe personelit kyç të agjentit TD

1. Agjenti TD njofton Autoritetin brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit, por jo më vonë se përfundimi i mandatit, për riemërimin e administratorit/anëtarit të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç.
2. Për çdo ndryshim të të dhënave, mbi bazën e të cilave është vlerësuar dhe miratuar administratori, anëtar i këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç, agjenti TD njofton me shkrim Autoritetin, brenda 10 ditëve nga ndryshimi i këtyre të dhënave.
3. Për çdo person që do të riemërohet si administrator, anëtar i këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës ose personel kyç, agjenti TD duhet të depozitojë vendimin e organit kompetent për riemërimin, shoqëruar me një CV të përditësuar sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1, aneksi 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Neni 33

Procedura për miratimin e ndryshimeve

1. Autoriteti shqyrton kërkesën dhe dokumentet shoqëruese dhe merr vendim në lidhje me miratimin ose jo të ndryshimeve brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës.
2. Mënyra e shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve dhe vlerësimi i tyre kryhen në përputhje me dispozitat e nenit 5, të kësaj rregulloreje.

KREU V

RAPORTIMI NË AUTORITET

Neni 34

Detyrimet për raportim

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore, agjenti TD njofton ose raporton me shkrim Autoritetin, brenda 14 ditëve pune nga ndodhitë e mëposhtme:
 - a. Ndryshimi i adresës dhe çdo ndryshim i të dhënave të kontaktit, menjëherë pas bërjes efektive të këtyre ndryshimeve;
 - b. Çdo propozim në lidhje me ndryshime thelbësore në shoqërinë e tij, të paktën një muaj përpara se ndryshimi i propozuar të hyjë në fuqi;
 - c. Vënia në dijeni për çdo indicie ose provë që vërteton, ose ndihmon të vërtetojë, veprimtaritë mashtruese ose të pandershme të punonjësve dhe/ose klientëve të tij, menjëherë nga moment i vënies në dijeni të tij;
 - ç. Marrja e vendimit për të bërë një kërkesë për demshpërblim në kuadër të sigurimit profesional, garancisë bankare, ose në kuadër të ndonje police tjetër sigurimi mbi biznesin e agjentit TD. Njoftimi në Autoritet duhet të bëhet para se të merret njoftimi i vendimit përkatës për palën tjetër të agjentit TD, në mënyrë që çdo koment i dhënë nga Autoriteti të merret parasysh përpara zbatimit të këtij vendimi;
 - d. Përfshirjen e agjentit TD ose personelit kyç të tij si palë ndërgjygjëse, menjëherë pas marrjes së njoftimit në lidhje me këto procese gjyqësore;
 - dh. Çdo ndryshim në dokumentet dhe/ose informacionin e depozituar pranë Autoritetit, menjëherë pas vënies në dijeni;
 - e. Çdo informacion tjetër thelbësor në lidhje me veprimtarinë e agjentit TD, funksionarëve të tij, brenda ose jashtë Shqipërisë;
 - ë. Çdo shkelje të kërkesave për licencim për agjentin TD të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, menjëherë sapo vendoset në dijeni për shkeljet;
 - f. Çdo shkelje të kërkesave për licencim të përcaktuara në legjislacionin në fuqi nga ana e klientëve të agjentit TD, menjëherë sapo ky i fundit vendoset në dijeni për shkeljen;
 - g. Të gjitha njoftimet përkatëse të kërkuara në ligj në lidhje me detyrimet e titullarëve të licencës, në rastet kur kërkohet përfshirja e agjentit TD.
2. Pavarësisht nga sa më sipër, Autoriteti rezervon të drejtën të kërkojë në çdo kohë informacion shtesë, për të siguruar që ofrimi i shërbimeve nga agjenti TD të kryhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Neni 35

Vetëdeklarimi vjetor

1. Në përputhje me nenin 29, pika 7, të ligjit, brenda muajit të dymbëdhjetë nga data e marrjes së licencës dhe brenda muajit janar të cdo viti të mëpasshëm, agjenti TD duhet të hartojë dhe dorëzojë pranë Autoritetit vetëdeklarimin vjetor përmes së cilit garantohet

përputhshmëria ligjore e veprimtarisë së tij. Vetëdeklarimit vjetor të agjentit TD duhet t'i bashkëlidhen së paku:

- a. Dokumente që vërtetojnë përfundimin me sukses të programeve të detyrueshme të trajnimit;
 - b. Dokumente që vërtetojnë mbajtjen në vazhdimësi të nivelit të kërkuar kapitalit rregullator;
 - c. Dokumente në lidhje me ndryshime në strukturën menaxhuese të agjentit TD, ku përfshihen ndryshimet e administratorit, anëtarëve të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç;
 - d. Politikat dhe rregullat e brendshme të funksionimit, të përditësuara;
 - e. pasqyrat financiare vjetore.
2. Autoriteti shqyrton vetëdeklarimin vjetor dhe dokumentet sipas pikës 1 të këtij neni brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune nga marrja në dorëzim e tyre.
 3. Autoriteti rezervon të drejtën për të kërkuar informacione ose dokumente shtesë, të cilat vihen në dispozicion nga agjenti TD jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga data e paraqitjes së kërkesës nga Autoriteti. Në këtë rast, afati 30 (tridhjetë) ditor i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, pezullohet deri në momentit e dorëzimit të plotë të informacionit dhe/ose dokumenteve të kërkuara. Në çdo rast, afati i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni nuk paragjykon të drejtën e Autoritetit për të kërkuar në çdo kohë informacion ose dokumente shtesë në lidhje me veprimtarinë e agjentit TD dhe/ose titullarëve të licencës për të cilët vepron në emër dhe për llogari, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
 4. Në rast të konstatimit të mospajtueshmërisë së agjentit TD me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe/ose legjislacionit në fuqi, Autoriteti ndërmerr masat administrative të parashikuara në nenin 19 dhe në kreun XI të ligjit.

Neni 36 Auditimi

Agjenti TD dorëzon pasqyrat financiare vjetore të audituara, të përgatitura në përputhje me standardet e kontabilitetit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

KREU VI DISPOZITA KALIMTARE

Neni 37 Licenca e kufizuar e agjentit TD

1. Gjatë 12 muajve të parë nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, subjektet kërkuar mund të aplikojnë për një licencë të kufizuar të agjentit TD, në përputhje me dispozitat e këtij kreu.
2. Licenca e kufizuar e agjentit TD i mundëson titullarëve të tij asistimin e subjekteve kërkuar gjatë procesit paraprak të plotësimit të kushteve të përgjithshme dhe kritereve të veçanta për licencë të bursës DLT, kujdestarit të portofolit të palëve të treta dhe/ose

subjekteve kërkues për autorizimin e ICO/STO, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 38

Veprimtaria e lejuar për titullarët e licencës së kufizuar të agjentit TD

1. Titullarët e licencës së kufizuar të agjentit TD do të lejohen të ushtrjnë vetëm veprimtaritë e mëposhtme:
 - a. Pranimin e klientëve të interesuar për të ushtruar veprimtarinë si:
 - i. Bursë DLT;
 - ii. Kujdestar i portofolit të palëve të treta dhe/ose;
 - iii. Emetuesve të interesuar për të lancuar një ICO ose STO në, ose nga Shqipëria.
 - b. Mbështetjen e subjekteve të listuara në pikën 1, shkronja a) të këtij neni në përgatitjen e të gjithë paketës së dokumenteve për licencim ose autorizim, sipas rastit. Kjo veprimtari përfshin ndër të tjera edhe dhënien e asistencës në përzgjedhjen e ofruesve të shërbimeve, hartimin e rregulloreve të brendshme, procedurave dhe politikave, themelimin e shoqërive, si dhe shërbime të tjera konsulence strategjike ose rregullatore.
2. Titullari i licencës së kufizuar të agjentit TD duhet të marrë të gjitha masat për të garantuar një strukturë tarifash transparente dhe të arsyeshme, të cilat duhet të përpilohen duke marrë në konsideratë kufizimin kohor dhe kufizimin e veprimtarive të lejuara nën këtë licencë.
3. Në rastet kur titullari i licencës së kufizuar të agjentit TD nuk arrin të marrë një licencë si agjent TD brenda 3 muajve nga marrja e licencës së kufizuar, klientëve të tij u lind e drejta të ndërpresin marrëdhënien me të pa u detyruar të paguajnë asnjë lloj penalteti për terminimin e kontratës ose çdo lloj detyrimi tjetër kundrejt tij. Titullari i licencës së kufizuar të agjentit TD vepron gjithnjë në mënyrë bashkëpunuese dhe transparente gjatë procesit të transferimit të dokumenteve të klientit tek agjenti TD i licencuar.

Neni 39

Paketa e dokumenteve për licencën e kufizuar të agjentit TD

1. Subjekti kërkues plotëson dhe dorëzon kërkesën për licencim sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje. Kërkesës për licencim i bashkëlidhet paketa e dokumenteve, sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.
2. Paketa e dokumenteve, e cila i bashkëlidhet kërkesës për licencë të kufizuar të agjentit TD përbëhet nga:
 - a. Dokumente mbi organizimin dhe veprimtarinë e shoqërisë, sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje;
 - b. Dokumente mbi reputacionin e subjektit kërkues dhe burimin e kapitalit, sipas nenit 11 të kësaj rregulloreje;
 - c. Dokumente mbi plotësimin e kriterëve të aftësisë dhe përshtatshmërisë, sipas neneve 24, 25 dhe 26 të kësaj rregulloreje;
 - ç. Dokumente mbi plotësimin e kriterit të kapitalit fillestar të shoqërisë.

3. Dokumentet, pjesë përbërëse të paketës së dokumenteve, duhet të jenë origjinal ose kopje të noterizuara të lëshuara jo më parë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes në Autoritet dhe shoqëruar, sipas rastit, me vulë apostile, sipas kërkesave të Ligjit nr. 9060, datë 8.5.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja”. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti ose të dokumenteve të pasakta përbëjnë shkak për refuzimin e kërkesës për licencim.

Neni 40

Dhënia e licencës së kufizuar të agjentit TD

1. Afatet dhe mënyra e shqyrtimi dhe vlerësimit të kërkesave për licencë të kufizuar të agjentit TD do të kryhen sipas përcaktimeve të kreut II të ligjit dhe kësaj rregulloreje.
2. Në rastet kur Autoriteti, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimit për licencë dhe paketës së dokumenteve bashkëlidhur, konstaton se subjekti kërkues i përmbush të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore për të ushtruar veprimtarinë e kufizuar si agjent TD, Autoriteti lëshon licencën e kufizuar të agjentit TD në emër të subjektit kërkues, sipas afateve të përcaktuara në nenin 11 të ligjit.
3. Autoriteti publikon vendimin për dhënien e licencës në faqen e tij zyrtare dhe e regjistron atë në regjistrin e agjentëve TD, sipas përcaktimeve të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, duke shtuar edhe shënimin përkatës për kufizimin e veprimtarive.

Neni 41

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

SHTOJCA I

FORMË KËRKESA PËR LICENCIMIN E AGJENTIT TD

Seksioni 1

Informacioni për subjektin kërkues

Informacioni i kërkuar	Plotësoni informacionin
Emri i shoqërisë	
Adresa e selisë qendrore	
Adresa e degëve të tjera të shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë, e ndryshme nga selia qendrore (nëse ka)	
Emri i personit të autorizuar	
Pozicioni i punës së personit të autorizuar	
Adresa e <i>e-mail</i> të personit të autorizuar	
Numri i telefonit të personit të autorizuar	
Adresa e faqes zyrtare të internetit, nëse është e aplikueshme	

Seksioni 2
Statusi i subjektit

2.1 Statusi

Informacioni i kërkuar	Plotësoni informacionin
Numri i identifikimit të shoqërisë (NUIS)	

Bashkëngjitni certifikatën e regjistrimit

2.2 Statuti i shoqërisë

Bashkëngjitni statutin/aktin e themelimit të shoqërisë së agjentit TD, ku objekti i veprimtarisë dhe kapitali minimal fillestar, të përputhet me veprimtaritë për të cilat subjekti kërkon të licencohet si dhe të përshkruhet roli i anëtarëve të këshillit të administrimit, shoqëruar me një përshkrim të detyrave dhe përgjegjësi të tyre.

Seksioni 3

Pronësia e subjektit kërkues

3.1 Zotëruesit e subjektit

Listoni të gjithë aksionarët e subjektit: personat fizikë sipas 3.1.1 dhe personat juridikë sipas 3.1.2

3.1.1 Aksionarin Personat fizikë/individë

Emri/Mbiemri i aksionarit Person fizik	Shtetësia e aksionarit	Numri personal i identifikimit/ Numri pasaportës për shtetasit e huaj	Numri i aksioneve të emetuara	Vlera e aksioneve	Përqindja e zotëruar

Bashkëngjitni aplikimit sa më poshtë:

Një kopje të kartës së identitetit (ose një kopje të pasaportës për shtetasit e huaj) për çdo CV;

Curriculum Vitae dhe vetëdeklarim për çdo person fizik i cili është aksionar. Curriculum Vitae dhe vetëdeklarimi për çdo person duhet të plotësohen sipas formatit të paraqitur në aneksin e kësaj shtojce;

Dëshmi të burimeve të krijimit të kapitalit si blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka dhe/ose degë të bankave të huaja apo dëshmi të tjera për burimin e krijimit të kapitalit;

Dokument të lëshuar nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;

Vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredive në sistemin bankar;

Dokumentacion të lëshuar nga organet kompetente, si më poshtë:

- *Vërtetim i gjendjes gjyqësore;*
- *Vërtetim nga prokuroria për hetim penal në proces;*
- *Vërtetim nga gjykata për çështje gjyqësore në proces;*

- Dokument lidhur me procese ekzekutimi të detyrueshëm apo për detyrime pasurore të pashlyera.

Deklaratë personale për lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë, sipas aneksit 3 të kësaj shtojce.

3.1.2 Aksionarit personat juridikë

Emri i aksionarit Person juridikë	Adresa	Numri i identifikimit (NUIS)	Objekti i aktivitetit	Numri i aksioneve të emetuara	Vlera e aksioneve	Përqindja e zotëruar

Bashkëngjitni aplikimit sa më poshtë:

Pasqyrat financiare të audituara për 3 vitet e fundit. Në rastin e një shoqërie më të re, pasqyrat që nga krijimi;

Dokument të lëshuar nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;

Vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredisë në sistemin bankar;

Deklaratë se shoqëria nuk është nën hetim dhe/ose proces gjyqësor për kryerjen e ndonjë vepre penale;

Dokument se shoqëria nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera;

AMF gjithashtu mund të kërkojë informacion mbi personat fizikë të lidhur me zotëruesit dhe me zotëruesit e zotëruesve.

Seksioni 3.1.3

Zotëruesit e aksioneve të aksionarit (personat juridikë dhe personat fizikë) deri tek aksionarët përfitues fundorë të subjektit kërkues.

Emri i aksionarit deklarues _____

Emri i shoqërisë	Numri i aksioneve në zotërim	Vlera e aksioneve	Përqindja e kapitalit aksionar të zotëruar	Numri i identifikimit (NUIS)/ Numri personal i identifikimit	Objekti i aktivitetit

(Kërkuesi të shtojë tabela sa janë të nevojshme për të gjithë aksionarët)

Seksioni 3.1.4

Aksionet/kuotat e zotëruara nga aksionarët me pjesëmarrje influencuese (personat fizikë dhe personat juridikë) të subjektit kërkues në shoqëri të tjera ku janë aksionarë/ortakë kryesorë ose ushtrojnë kontroll.

Emri i aksionarit deklarues _____

Emri i shoqërisë	Numri i aksioneve në zotërim	Vlera e aksioneve	Përqindja e kapitalit aksionar të zotëruar	Numri i identifikimit (NUIS)	Objekti i aktivitetit

(Kërkuesi të shtojë tabela sa janë të nevojshme për të gjithë aksionarët)

Seksioni 4

Kapitali i subjektit kërkues

4.1 Kapitali i paguar (sipas kërkesave të nenit 29 të ligjit)

Kapitali i paguar - LEK	Emri i aksionarit	Burimi i kapitalit
[total]	Kapitali i përgjithshëm i paguar	

Bashkëngjitni vërtetimin bankar që konfirmon pagesën në para, për llogari të shoqërisë, të kapitalit minimal fillestar në përputhje me nenin 29 të ligjit, i cili duhet të mbahet i bllokuar në favor të Autoritetit, në një nga bankat e nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë.

Seksioni 5

Administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës

5.1 Administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit/anëtarët e këshillit mbikëqyrës të Agjentit TD

Për çdo person jepni informacionin e mëposhtëm:

Titulli (Z, Znj, Dr, etj)	Informacioni i kërkuar
Emri	
Mbiemri	
Pozicioni i punës	
Adresa	
Adresa e e-mail	
Numri i telefonit	
Nënshtetësia	
Numri i identifikimit ose numri i pasaportës	

Bashkëngjitni kërkesës sa më poshtë:

Një kopje të kartës së identitetit (ose një kopje të pasaportës për shtetasit e huaj) për çdo CV; Curriculum Vitae dhe vetëdeklarim për çdo administrator dhe anëtar të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës. Curriculum Vitae dhe vetëdeklarimi për çdo person duhet të plotësohen sipas formatit të paraqitur në aneksin e kësaj shtojce;

Dokument të lëshuar nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;

Vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredive në sistemin bankar.

Dokumentacion të lëshuar nga organet kompetente, si më poshtë:

- ***Vërtetim i gjendjes gjyqësore;***
- ***Vërtetim nga prokuroria për hetim penal në proces;***
- ***Vërtetim nga gjykata për çështje gjyqësore në proces;***
- ***Dokument lidhur me procese ekzekutimi të detyrueshëm apo për detyrime pasurore të pashlyera.***

Deklaratë personale për lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë, sipas aneksit 3 të kësaj shtojce.

Deklaratë personale se:

- a) *Nuk është përfshirë, ka bashkëpunuar ose është i lidhur me humbje financiare, të shkaktuara nga veprimet e pandershme, të papërgjegjshme apo neglizhente, në lidhje me kryerjen e shërbimeve financiare dhe administrimin e shoqërive të tjera; ose*
- b) *Nuk ka zotëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të paktën 50% të të drejtave të votës apo të kapitalit të një shoqërie tregtare, ose ka qenë administrator i një shoqërie tregtare, e cila është bërë objekt i procedurave të falimentimit, në zbatim të ligjit për falimentimin;*
- c) *Nuk është përfshirë në ndonjë praktikë tregtare, përfshirë edhe evazionin fiskal dhe pastrimin e parave, që Autoriteti e konsideron të papërshtatshme, qoftë e ligjshme ose jo, e cila hedh dyshime për mënyrën e kryerjes së shërbimeve financiare apo të veprimtarive të tjera tregtare nga ky person.*

Seksioni 6

Dokumentet mbi organizimin dhe veprimtarinë e shoqërisë

1. Ekstraktin e regjistrimit në QKB të subjektit kërkues.
2. Statutin, ku objekti i veprimtarisë dhe kapitali minimal fillestar, të përputhet me veprimtarinë për të cilat subjekti kërkon të licencohet si dhe të përshkruhet roli i anëtarëve të pavarur të këshillit të administrimit, shoqëruar me një përshkrim të detyrave dhe përgjegjësive të tyre.
3. Lista e shërbimeve dhe aktiviteteve të që synohen të kryhen.
4. Strukturën organizative/organigramën e shoqërisë, me përshkrimin mbi funksionet dhe përgjegjësitë e personelit kyç.
5. Planin e biznesit për të paktën tre vitet e para të aktivitetit sipas kërkesave specifike të përcaktuara në pikën 5, neni 11 të rregullores.
6. Kontrata e punës me administratorin.
7. Deklaratën e përgjegjësisë, ku të përshkruhen përgjegjësitë e funksionarëve të cilësuar si personel kyç, si dhe përshkrimin e funksioneve dhe përgjegjësive kryesore, në rastet kur një funksionar do të ushtrojë më shumë se një funksion të përcaktuar për personelin kyç.
8. Nëse shoqëria ka ushtruar një aktivitet tjetër përpara kërkesës për të ushtruar veprimtarinë si agjent TD, përveç dokumenteve të mësipërme, duhet të depozitohet gjithashtu:
 - a) Pasqyrat financiare të audituara për 3 vitet e fundit, dhe në rastin e një shoqërie më të re pasqyrat që nga krijimi;
 - b) Vërtetim nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;
 - c) Deklaratëse shoqëria nuk është nën hetim dhe/ose proces gjyqësor për kryerjen e ndonjë vepre penale.

Rregullat, procedurat dhe sistemet

1. Përshkrim mbi sistemin e teknologjisë së informacionit, të kontabilitetit dhe të kontrollit.
2. Procedura dhe kontrole lidhur me mënyrat e identifikimit të rasteve të konfliktit të interesit.
3. Përshkrimin e procedurave që do të zbatohen për të garantuar zbatimin e të gjitha kërkesave rregullatore, me qëllim mbrojtjen e interesave të investitorëve dhe ruajtjen e integritetit të tregut.
4. Procedura lidhur me njohjen, kategorizimin, përshtatshmërinë dhe marrëdhëniet me klientin.
5. Masat për veçimin dhe identifikimin e mjeteve të klientëve.
6. Kontrata tip me klientin.
7. Ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, përfshirë të gjitha shërbimet dhe transaksionet e ndërmarra.
8. Procedura për trajtimin dhe zgjidhjen në kohë të çdo mosmarrëveshjeje dhe ankese të bërë nga klientët.

9. Procedura/rregulla mbi mbajtjen e regjistrave të veprimeve/transaksioneve, përditësimin dhe ruajtjen e regjistrave si dhe çdo kërkesë tjetër ligjore të lidhur me regjistrimet e veprimtarisë së kryer.
10. Informacion për sistemin e kontrollit të brendshëm, si dhe informacion për procedurat operacionale.
11. Procedura në përputhje me kërkesat e raportimit në Autoritet.
12. Procedurat mbi përputhshmërinë me legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave.
13. Dokument që vërteton shlyerjen e pagesave ndaj Autoritetit.
14. Rregullore të brendshme në lidhje me delegimin e funksioneve/detyrave (Outsourcing).
15. Rregullore të brendshme në lidhje me sigurinë kibernetike.
16. Rregullore për menaxhimin e rrezikut.
17. Rregullore të brendshme për parandalimin e abuzimit të tregut.

NËNSHKRIMI I DEKLARIMIT

Ne, të nënshkruarit, vërtetojmë se:

Jemi në dijeni se është vepër penale dhënia me dashje Autoritetit e informacionit të rremë, çorientues ose mashtrues;

Jemi në dijeni se kjo kërkesë do të refuzohet nëse nuk kemi dhënë informacionin e kërkuar nga Ligji nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë” dhe Rregulloren “Për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si agjent i tokenit digjital”;

Konfirmojmë që informacioni i dhënë në këtë aplikim është i saktë dhe i plotë për aq sa jemi në dijeni dhe do të njoftojmë menjëherë Autoritetin nëse ka një ndryshim të rëndësishëm në informacionin e dhënë;

Jemi në dijeni që Autoriteti mund të bëjë kërkime dhe të kërkojë informacione të mëtejshme kur e gjykon si të përshtatshme për të identifikuar dhe verifikuar informacionet që i konsideron të rëndësishme për vlerësimin e këtij aplikimi;

Jemi dakord që Autoriteti mund të ndërmarrë kontrole me autoritete të tjera rregullatore në lidhje me personat të cilëve u referohet ky aplikim;

Kemi bashkëngjitur dokumentet përkatëse aty ku kërkohet dhe kemi marrë të gjitha hapat e arsyeshëm për të verifikuar që ato janë të sakta;

Jemi në dijeni se Autoriteti mund të kërkojë në çdo kohë dhënien e informacioneve ose dokumenteve të tjera shtesë;

Jemi në dijeni se paguhet një tarifë e pakthyeshme e aplikimit përpara se një kërkesë për licencë të konsiderohet nga Autoriteti dhe se një tarifë për licencim paguhet pas dhënies së licencës;

Konfirmojmë se jemi të autorizuar të nënshkruajmë këtë kërkesë në emër të kërkuarit;

Konfirmojmë se individët e specifikuar në këtë kërkesë janë të vetëdijshëm se për qëllime të përputhjes me Ligjin nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të dhënat personale mund të përdoren nga Autoriteti për të përmbushur detyrimet e tij ligjore dhe në përputhje me atë ligj dhe këto të dhëna nuk do të përdoren për qëllime të tjera pa lejen e individit përkatës;

Jemi të vetëdijshëm që pas licencimit shoqëria jonë ka përgjegjësi të informojë Autoritetin për çështje të cilat duhet në mënyrë të arsyeshme t'i njoftohen Autoritetit duke përfshirë ndryshime e rëndësishme sipas Ligjit “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”;

Jemi të vetëdijshëm se përgjegjësia për saktësinë e informacionit, si dhe dhënia e informacionit përkatës, në këtë aplikim është përgjegjësi e atyre që nënshkruajnë aplikimin;

Firma.....
Emri i plotë.....
Pozicioni i punës i personit

Firma.....
Emri i plotë.....
Pozicioni i punës i personit

Firma.....
Emri i plotë.....
Pozicioni i punës i personit

Data e kërkesës

ANEKSI 1
FORMATI I CURRICULUM VITAE

Kujdes: [secila faqe duhet të jetë e nënshkruar] dokumenti duhet të nënshkruhet nga personi në fjalë

1. Të përgjithshme

Informacioni i kërkuar	Plotësoni informacionin
Titulli (Z, Znj, Dr, etj)	
Emri	
Mbiemri	
Titulli/pozicioni i punës i propozuar nga personi juridik	
Adresa e <i>e-mail</i>	
Numri i telefonit	
Adresa e vendbanimit	
Nënshtetësia	
Numri i identifikimit ose numri i pasaportës	

2 Kualifikimet - profesionale

Kualifikimi	Organizata profesionale	Data e kualifikimit

Bashkëngjitni një kopje të kualifikimeve profesionale në Curriculum Vitae [ose një link të faqes së internetit, ku mund të verifikohet]

3 Arsimimi - diplomë / master / doktoraturë

Kualifikimi	Institucioni akademik	Data e kualifikimit

Bashkëngjitni një kopje të kualifikimeve akademike në Curriculum Vitae [ose një link të faqes së internetit, ku mund të verifikohet]

4 Fushat kryesore të aftësive

--

5 Përvoja profesionale

Datat (fillimi dhe mbarimi)	Punëdhënësi	Pozicioni	Përshkrimi i funksioneve të kryera

6 Përvoja të tjera të rëndësishme (kurse dhe trajnime)

Data/kohëzgjatja	Lloji i kursit	Lënda

7 Zotërimet në shoqëri/pjesëmarrja në ortakëri në datën e aplikimit

Emri i shoqërisë / ortakërisë	Numri i identifikimit (NUIS)	Objekti i aktivitetit	Përqindja e zotërimit të pronësisë / numri i ortakëve

Deklaratë mbi informacionin personal

[Shënoni kutinë përkatëse – nëse përgjigja për ndonjë nga pyetjet është po, plotësoni informacionin në kutinë e dhënë më poshtë në këtë formular]

Sjellja e përgjithshme

A keni qenë gjatë pesë viteve të fundit në Shqipëri ose në një vend tjetër, të angazhuar ose keni pasur lidhje ose keni qenë subjekt i penalteteve rregullatore, për humbje financiare për shkak të pandershmërisë, paaftësisë ose neglizhencës në ofrimin e shërbimeve financiare apo menaxhimit të shoqërive?

Po Jo

A keni qenë në pesë vitet e fundit brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër të angazhuar në praktika biznesi duke përfshirë evazionin fiskal, që Autoriteti i gjykon si të papërshtatshme edhe nëse ato kanë qenë praktika të ligjshme, ose që pasqyrojnë një qasje të papërshtatshme të personit për kryerjen e shërbimeve financiare ose bizneseve të tjera?

Po Jo

A keni qenë të angazhuar ose keni qenë pjesë e ndonjë hetimi apo ndëshkimi rregullator për ndonjë praktikë biznesi, duke përfshirë evazionin fiskal dhe pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit?

Po Jo

Licencat

Brenda pesë viteve të fundit, në Shqipëri ose në një vend tjetër, a ju është refuzuar ndonjëherë e drejta, apo jeni kufizuar në të drejtën, që të vazhdoni veprimtarinë e shërbimeve financiare për të cilat kërkohet me ligj licencimi?

Po Jo

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a keni qenë ndonjëherë subjekt i masave disiplinore në lidhje me ndonjë licencë?

Po Jo

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a keni qenë ndonjëherë objekt i ndonjë hetimi apo procesi që është aktual ose i pazgjidhur dhe që mund të rezultojë në marrjen e masave disiplinore në lidhje me ndonjë licencë?

Po Jo

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a keni qenë ndonjëherë i angazhuar në administrimin e ndonjë shoqërie/biznesi që ka qenë subjekt i likuidimit të detyrueshëm?

Po Jo

Anëtarësimi Profesional, Akreditimi dhe Sigurimi Profesional

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a ju është refuzuar pranimi në një shoqatë profesionale ose apo ju ka përfunduar anëtarësimi në këtë shoqatë?

Po Jo

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a keni qenë ndonjëherë i skualifikuar apo i përjashtuar nga një organ profesional ose rregullator në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me ndershmërinë, integritetin ose sjelljen tuaj të biznesit?

Po Jo

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a keni patur ndonjëherë ndonjë kërkesë për dëmshpërblim lidhur me përgjegjësi profesionale?

Po Jo

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a jeni refuzuar ndonjëherë për sigurimin e përgjegjësive profesionale?

Po Jo

Emrat

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a keni kryer ndonjëherë biznes me ndonjë emër tjetër përveç emrit apo emrave të njoftuar paraprakisht tek Autoriteti?

Po Jo

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a keni përdorur ndonjë emër tjetër përveç emrit apo emrave të njoftuar paraprakisht tek Autoriteti?

Po Jo

Shkeljet dhe krimi financiar

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a keni qenë ndonjëherë objekt i procedurave administrative, civile ose penale ose të veprimeve përmbarimore?

Po Jo

Brenda pesë viteve të fundit, a keni qenë në Shqipëri ose në një vend tjetër të dënuar me ligj për një shkelje që përbën shkelje të rëndë të rregullave të Autoritetit ose autoriteteve të tjera kompetente brenda dhe jashtë vendit?

Po Jo

Aftësia paguese

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a keni qenë ndonjëherë objekt i procedurave të falimentimit, paaftësisë paguese apo administrimit të përkohshëm?

Po Jo

Brenda pesë viteve të fundit, në Shqipëri ose në një vend tjetër, a keni qenë ndonjëherë i angazhuar në administrimin e ndonjë shoqërie/biznesi që ka hyrë në një kompromis apo skemë marrëveshje me kreditorët e saj për shkak të paaftësisë për të përmbushur detyrimet kreditore?

Po Jo

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a keni qenë ndonjëherë i angazhuar në administrimin e ndonjë shoqërie/biznesi që janë deklaruar me paftësi paguese?

Po Jo

Shpjegimet

Nëse ju jeni përgjigjur po për çdo pyetje lidhur me vetëdeklarimin, jepni një shpjegim për çdo çështje në kutinë më poshtë.

Curriculum Vitae dhe Vetëdeklarimi

Unë, [*shëno emrin e plotë*], vërtetoj se:

Kjo Curriculum Vitae paraqet me saktësi statusin, kualifikimin dhe përvojën time të punës;

Jam i vetëdijshëm për përgjegjësitë dhe llogaridhënien time në lidhje me aplikantin;

Nuk jam i angazhuar në aktivitete ose profesione të tjera biznesi që çenojnë integritetin, pavarësinë dhe aftësitë profesionale;

Do të veproj në përputhje me standardet dhe etikën profesionale dhe do të respektoj ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Firma:

Emri:

Datë:

ANEKSI 2
VETËDEKLARIMI PËR PERSONIN JURIDIK QË ËSHTË ZOTËRUES I PJESËMARRJES
INFLUENCUESE NË NJË SHOQËRI AGJENTI TD

Emri i shoqërisë	
Numri i identifikimit të shoqërisë (NUIS)	
Adresa e regjistruar e shoqërisë	
Numri i telefonit të kontaktit	
Adresa e <i>e-mail</i> të kontaktit	

Deklarata e informacionit

[Shënoni kutinë përkatëse – nëse përgjigja për ndonjë nga pyetjet është po, plotësoni informacionin në kutinë e dhënë më poshtë në këtë formular]

Sjellja e përgjithshme

A ka qenë personi juridik gjatë pesë viteve të fundit në Shqipëri ose në një vend tjetër, i angazhuar ose ka pasur lidhje ose ka qenë subjekt i penaliteteve rregullatore, për humbje financiare për shkak të pandershmërisë, paaftësisë ose neglizhencës në ofrimin e shërbimeve financiare apo menaxhimit të shoqërive?

Po Jo

A ka qenë personi juridik i angazhuar në praktika biznesi duke përfshirë evazionin fiskal, që Autoriteti i gjykon si të papërshtatshme edhe nëse ato kanë qenë praktika të ligjshme, ose që pasqyrojnë një qasje të papërshtatshme të personit për kryerjen e shërbimeve financiare ose bizneseve të tjera?

Po Jo

A ka qenë personi juridik i angazhuar ose ka qenë pjesë e ndonjë hetimi apo ndëshkimi rregullator për ndonjë praktikë biznesi, duke përfshirë evazionin fiskal dhe pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit?

Po Jo

Licencat

Brenda pesë viteve të fundit, në Shqipëri ose në një vend tjetër, a i është refuzuar personit juridik ndonjëherë e drejta, apo është kufizuar në të drejtën, që të vazhdojë veprimtarinë e shërbimeve financiare për të cilat kërkohet me ligj licencimi?

Po Jo

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a ka qenë ndonjëherë personi juridik subjekt i masave disiplinore në lidhje me ndonjë licencë?

Po Jo

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a ka qenë ndonjëherë personi juridik objekt i ndonjë hetimi apo procesi që është aktual ose i pazgjidhur dhe që mund të rezultojë në marrjen e masave disiplinore në lidhje me ndonjë licencë?

Po Jo

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a ka qenë ndonjëherë personi juridik subjekt i likuidimit të detyrueshëm?

Po Jo

Statusi profesional dhe sigurimi profesional

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a i është refuzuar personit juridik pranimit në një shoqatë profesionale ose apo i ka përfunduar anëtarësimi në këtë shoqatë?

Po Jo

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a është qortuar ndonjëherë personi juridik ose skualifikuar apo larguar nga një organ profesional ose rregullator në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me ndershmërinë, integritetin ose sjelljen e biznesit?

Po Jo

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a keni patur ndonjëherë ndonjë kërkesë për dëmtshpërblim lidhur me përgjegjësi profesionale?

Po Jo

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a jeni refuzuar ndonjëherë për sigurimin e përgjegjësive profesionale?

Po Jo

Emrat

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a ka kryer ndonjëherë personi juridik biznes me ndonjë emër tjetër përveç emrit apo emrave të njoftuar paraprakisht tek Autoriteti?

Po Jo

Brenda pesë viteve të fundit, brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër, a është njohur ndonjëherë personi juridik me ndonjë emër tjetër përveç emrit apo emrave të njoftuar paraprakisht tek Autoriteti?

Po Jo

Shpjegimet

Nëse ju jeni përgjigjur po për çdo pyetje lidhur me vetëdeklarimin, jepni një shpjegim për çdo çështje në kutinë më poshtë.

Deklaratë:

Ne, të nënshkruarit, vërtetojmë se:

Jemi në dijeni se është vepër penale dhënia me dashje Autoritetit e informacionit të rremë, çorientues ose mashtrues;

Konfirmojmë që informacioni i dhënë në këtë dokument është i saktë dhe i plotë për aq sa jemi në dijeni dhe do të njoftojmë menjëherë Autoritetin nëse ka një ndryshim të rëndësishëm në informacionin e dhënë;

Jemi në dijeni që Autoriteti mund të bëjë kërkime dhe të kërkojë informacione të mëtejshme kur e gjykon si të përshtatshme për të identifikuar dhe verifikuar informacionet që i konsideron të rëndësishme për vlerësimin e këtij dokumenti;

Jemi dakord që Autoriteti mund të ndërmarrë kontrolle me [Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe rregullatorë të tjerë] në lidhje me personat të cilëve u referohet ky aplikim;

Konfirmojmë se jemi të autorizuar të nënshkruajmë këtë dokument;

Jemi të vetëdijshëm se përgjegjësia për saktësinë e informacionit, si dhe dhënia e informacionit përkatës, në këtë dokument është përgjegjësi e atyre që nënshkruajnë aplikimin.

Firma.....

Emri:

Pozicioni i punës.....

Datë:

Firma.....

Emri:

Pozicioni i punës.....

Datë:

ANEKSI 3

Deklaratë personale për lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë

Nëpërmjet së cilës, unë vërtetoj se kam/nuk kam lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë.

Shënim: Në rastin kur individit për t'u licencuar / miratuar / emëruar / riemëruar, deklaron se ka lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë, rendit në vijim emrat e personave.

Nr.	Emri i personit të lidhur me individin për t'u licencuar / miratuar/emëruar / riemëruar	Lloji i lidhjes (familjar e apo marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore), duke e specifikuar	Ka dënim penal të formës së prerë. (sqaro llojin e dënimit)
1			
2			
3			
....			

Vërtetoj se informacioni i dhënë, i paraqitet vullnetarisht nga unë, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Çdo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve në këtë raport mund të jetë shkak që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të refuzojë licencimin/miratimin/emërimin/riemërimin tim.

Në qoftë se kërkohet informacion shtesë ose më i detajuar, unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

(Emri/Mbiemri i individit për t'u licencuar / miratuar / emëruar / riemëruar)

_____/_____/_____
(Data)

(Nënshkrimi i plotë)

SHTOJCA 2 – KËRKESË PËR DORËZIMIN E LICENCËS

Datë ____/____/____

Drejtuar: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Rruga Dora D'istria, Nr.10, Tiranë, Shqipëri.

Email: amf@amf.gov.al

Lënda: Agjenti i Tokenit Digjital [_____] - Dorëzimi i vullnetar i licencës së agjentit TD

Të nderuar

Ju shkruaj në emër të Agjentit TD _____.

Në përputhje me nenin 9 të rregullores nr. ____ datë ____ “Për miratimin e rregullores së licencimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si agjent i tokenit digjital”, ju njoftoj zyrtarisht për dorëzimin e licencës së Agjentit TD me Nr. ____, të lëshuar nga Autoriteti në datë ____/____/____.

Në këtë kuadër Agjenti TD konfirmon sa më poshtë:

- a. Ka përfunduar të gjitha shërbimet ndaj klientëve aktualë;
- b. Nuk ka detyrime kundrejt palëve të treta;
- c. Ka trajtuar ankesat e mundshme ndaj tij në përputhje me politikat dhe rregullat e brendshme të tij dhe se nuk ka asnjë ankesë të patrajtuar;
- d. Konfirmon ruajtjen në vijimësi të fondeve të veta për të paktën 3 muaj
- e. Nuk është palë ndërgjyqëse në procese gjyqësore në Shqipëri

Për çdo pyetje lidhur me sa më sipër, mos hezitoni të na kontaktoni.

Me respekt,

[Emri]

[Pozicioni]

SHTOJCA 3

FORMULARI I NJOFTIMEVE TË NDRYSHIMEVE TË RËNDËSISHME

1. Informacioni i kontaktit për njoftuesin e ndryshimeve të rëndësishme

Informacioni i kërkuar	Plotësoni informacionin
Emri i subjektit njoftues	
Adresa e regjistruar e subjektit njoftues	
Emri i personit të kontaktit të subjektit njoftues	
Adresa e personit të kontaktit të subjektit njoftues	
Pozicioni i punës i personit të subjektit njoftues	
Adresa <i>e-mail</i> të personit të subjektit njoftues	
Numri i telefonit të personit të subjektit njoftues	
Adresa e faqes së internetit nëse është e aplikueshme	

2. Subjekti i licencuar për të cilin kryhet njoftimi

Informacioni i kërkuar	Plotësoni informacionin
Emri i subjektit	
Numri i licencës së subjektit njoftues (Agjenti TD)	
Numri i licencës së subjektit njoftues (Agjenti TD)	

3. Natyrën e ndryshimit të rëndësishëm që po njoftohet

Shënoni kutinë në seksionin përkatës sipas rastit
3.1 Ndryshimet e rëndësishme në lidhje me Agjentin TD

Referenca Rregullores për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si agjent i tokenit digjital	Kodi i ndryshimeve të rëndësishme	Natyra e ndryshimit	Shënoni sipas rastit
Neni 52, pika 1, germa b	01	Ofrimi në mënyrë direkte ose indirekte të shërbimeve të tij jashtë Republikës së Shqipërisë	
Neni 52, pika 1, germa c	02	Ndryshimi i nivelit kapitalin e tij ose të drejtat e aksionarëve të shoqërisë	
Neni 52, pika 1, germa d	03	Ndryshimi i zotëruesve të pjesëmarrjes influencuese	
Neni 52, pika 1, germa e	04	Emërimi, zëvendësimi i administratorit, anëtarëve të këshillit mbikëqyrës/ Këshillit të administrimit dhe Personelit Kyç, duke përfshirë ZPPPPFT	
Neni 53, pika 1, germa b	05	Ndërprerja e kryerjes së një ose më shumë shërbimeve për të cilat është licencuar	
Neni 54	06	Zotëruesit e pjesëmarrjes influencuese	
Neni 55	07	Ndryshimi i administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe personelit kyç	
Neni 56	09	Riemërimi i administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe personelit kyç	

4. Detajet e ndryshimit të rëndësishëm të propozuar

Përcaktoni ndryshimin e rëndësishëm të propozuar dhe arsyet për ndryshimin e propozuar në jo më shumë se 500 fjalë.

5. Nënshkrimi dhe deklarimi

Ne, të nënshkruarit, vërtetojmë se:

Jemi në dijeni se është vepër penale dhënia me dashje Autoritetit e informacionit të rremë, çorientues ose mashtrues;

Jemi në dijeni se njoftimi i ndryshimeve të rëndësishme do të refuzohet nëse nuk kemi dhënë informacionin e kërkuar nga Ligji nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë” dhe Rregulloren “Për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si agjent i tokenit digjital” ose nëse nuk është paguar tarifa e kërkuar;

Konfirmojmë që informacioni i dhënë në këtë aplikim është i saktë dhe i plotë për aq sa jemi në dijeni dhe do të njoftojmë menjëherë Autoritetin, nëse ka një ndryshim të rëndësishëm në informacionin e dhënë;

Konfirmojmë se nëse ndryshimi i njoftuar implementohet, zbatimi i tij nuk do të shkaktojë mospërputhje me Ligjin “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë” dhe rregulloreve sipas atij ligji;

Jemi në dijeni që Autoriteti mund të bëjë kërkime dhe të kërkojë informacione të mëtejshme kur e gjykon si të përshtatshme për të identifikuar dhe verifikuar informatat që i konsideron të rëndësishme për vlerësimin e këtij aplikimi;

Jemi dakord që Autoriteti mund të ndërmarrë kontrolle me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe autoritete të tjera rregullatore në lidhje me personat të cilëve u referohet ky aplikim;

Kemi bashkangjitur dokumentet përkatëse aty ku kërkohet dhe kemi marrë të gjitha hapat e arsyeshëm për të verifikuar që ato janë të sakta;

Jemi në dijeni se Autoriteti mund të kërkojë në çdo kohë dhënien e informacioneve ose dokumenteve të tjera shtesë;

Jemi në dijeni se pagesa e licencimit/aplikimit është e pakthyeshme;

Konfirmojmë se jemi të autorizuar të nënshkruajmë këtë njoftim në emër të aplikantit;

Konfirmojmë se individët e përcaktuar në këtë kërkesë janë të vetëdijshëm se për qëllime të përputhjes me Ligjin nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të dhënat personale mund të përdoren nga Autoriteti për të përmbushur detyrimet e tij ligjore dhe, në përputhje me atë ligj, dhe këto të dhëna nuk do të përdorën për qëllime të tjera pa lejen e individit përkatës;

Jemi të vetëdijshëm se përgjegjësia për saktësinë e informacionit, si dhe dhënia e informacionit përkatës në këtë aplikim është përgjegjësi e atyre që nënshkruajnë aplikimin.

Firma.....
Emri i plotë.....
Pozicioni i punës i personit

Firma.....
Emri i plotë.....
Pozicioni i punës i personit

Firma.....
Emri i plotë.....
Pozicioni i punës i personit